

## **Informacion mbi grante të përfituara nga ana e Gjykatës Kushtetuese**

Gjykata Kushtetuese, referuar kontratës nr. 81079531, datë 07.12.2023, mes Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ka përfituar një grant në vlerën prej 6,636,000 lekë, për realizimin e projektit me titull “Rritja e transparencës dhe aksesit në drejtësinë kushtetuese”. Ky projekt është zbatuar gjatë vitit 2024 për të gjithë zërat e parashikuar dhe të buxhetuar, në përputhje me kontratën e sipërpërmendur.

Projekti “Rritja e transparencës dhe aksesit në drejtësinë kushtetuese” synoi sjelljen e së drejtës së informimit në përputhje me standardet ndërkombëtare, nëpërmjet:

1. ridizenjimit të faqes zyrtare të Gjykatës Kushtetuese;
2. forcimit të marrëdhënieve me median dhe publikun përmes tryezave të rrumbullakëta;
3. forcimit të bashkëpunimit me gjykatat e tjera, avokatinë apo subjektet e interesuara;
4. botimeve profesionale për të drejtën kushtetuese dhe jurisprudencën kushtetuese për profesionistë të ligjit (buletini elektronik periodik i Gjykatës Kushtetuese), si dhe botimeve ndërgjegjësuere për të rinjtë.